



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-8081-2-2-1/C1119
14 Nr. 1160/25
Dt. 10.10.2025

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi– Drejtor i Prokurimit** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. **Tili Cleaning SH.P.K** emri i biznesit - **Tili Cleaning SH.P.K** emri tregtar me seli në **Vushtrri**, me **ARBK: 812021476** si **Operator Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Bahtir Mehmeti**, në tekstin e mëtejme **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Larja e veturave për 36 muaj të automjeteve për nevoja të A.K. - Vushtrri, me numër identifikues:

Nr. i Prokurimit	VU644	2	5	80	8	1	2	2	1
Nr. I brendshëm	VU644	2	5	0	5	8	2	2	1

Neni 1 Lënda Larja e veturave për 36 muaj

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të pastrimit dhe larjes së automjeteve të Autoritetit Kontraktues**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-25-8081-2-2-1**.
- 1.2 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari pas datës së nënshkrimit të kontratës, respektivisht nga data **10.10.2025** dhe përfundon më dt. **09.10.2028** duke përfshirë edhe këtë datë.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mund të lejohet një mospërputhje e cila nuk mund të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).

- 1.5 Nëse Urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.
- 1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Çmimeve, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Menaxheri i Kontratë dhe Komisioni i Pranimit të shërbimeve nuk duhet të lejojnë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të mallit për atë pozicion ose artikull.
- 1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e mallrave të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës. Shërbimet do të ekzekutohen mbi bazën e Porosisë nga personi përgjegjës – kompetent i Njesisë Kërkuese të A.K., në këtë rast Menaxheri i Kontratës i A.K. dhe / ose drejtuesi i automjetit të autoritetit kontraktues ndërsa shërbimet duhen përfunduar menjëherë, në cilësi dhe përshtatshmëri sipas përshkrimit teknik.
- 2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: 17,850.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë tetëqindëpesëdhjetë/00 Euro).
- 3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetëpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me sasinë respektivisht numrin e automjeteve të pastruara. Automjetet e pastruara sipas përshkrimit teknik duhen të jenë të evidentuara në Raportin – Regjistrin e automjeteve të cilat janë pastruar, ndërsa Raporti duhet të jetë i aprovuar me nënshkrim nga Menaxheri i Kontratës dhe drejtuesi i automjetit të njesisë shpenzuese përkatëse. Në raport duhet theksuar se shërbimet e porositura, nga Kontraktuesi janë përfunduar në kohë, në mënyrë cilësore dhe sasiore, duke respektuar kushtet e kontratës dhe Përshkrimin Teknik, pjesë përbërëse të kësaj kontrate.
- 3.5 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa - Fatura e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

- 4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Komuna e Vushtrrisë

Për Ofruesin e Shërbimeve

Tili Cleaning SH.P.K

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Bahtir Mehmeti
Pozita:	Drejtor i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.10.2025	Data:	10.10.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Vushtrisë**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **TILI CLEANING SHPK , RR. ENVER ZUMBERI PN Vushtrri**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: **LARJA E VETURAVE PER 36 MUAJ**
NR. I KONTRATES: 644-25-8081-2-2-1/C1119

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Nje mije e Shtate qinde e Tetedhjetë e Pes 1,785.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,785.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **1126** ditë prej **10.10.2025** deri më **09.11.2028**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
10.10.2025

SIGURIMI I GARANCIVE / POLICA E SIGURIMIT



Dega MITROVICË

Numri i polices 060070040101439

1 Të dhënat për agentin - Agent details

Emri dhe mbiemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Zeqir Hasani	Mitrovicë Filiala	044/198-465	007004

2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit "SIGKOS" sh.a., Prishtinë

I SIGURUARI	TILI CLEANING SHPK		
Adresa	RR. ENVER ZUMBERI PN Vushtri		
Përfaqësuar nga Z.	BAHTIR MEHMETI	Nr. i biznesit	812021476

3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji:	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT
LARJA E VETURAVE PER 36 MUAJ NR. I KONTRATES: 644-25-8081-2-2-1/C1119	

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfutuesi	Komuna e Vushtrisë
Adresa	SHESHI " HASAN PRISHTINA" Nr.173
Shuma e siguruar €	1,785.00 €

4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efekt veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfutuesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfutuesi nuk mund të paraqesë kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfutuesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfutuesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfutuesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfutuesit (cedimi i të drejtave nga Përfutuesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë	Fillon me: 10.10.2025	Mbaron me: 09.11.2028
--------------------------------	-----------------------	-----------------------

5

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
1,785.00 €	154.25 €	27.76 €	182.01 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht Premium is paid completely	182.01 €	Datë Data	10.10.2025	Me Këste: Numri i kësteve In-Installments: Nr. of inst.	
Shënime tjera:					
I Siguruari / The Insured		Data e lëshimit / Issued date		Siguruesi / The Insurer	
BAHTIR MEHMETI		10.10.2025		Zeqir Hasani	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 1162/25
Dt. 13.10.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese DKA-së dhe ZPP-së, më dt. **12.10.2025** merë:

V E N D I M

Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Larja e veturave për 36 muaj të automjeteve për nevoja të A.K, me numër të prokurimit VU644-25-8081-2-2-1: dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-25-058-2-2-1** si vijon :

z.Fahri Mehulli, emërohet menaxher i kontratës.

z.Benjamin Shala mërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhohi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zytari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do ti krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zytari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do ti lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me kushtet e Kontratës dhe Porositë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkojë mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpilojë – lëshoi një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm

- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Operatorit Ekonomik: **Tili Cleaning SH.P.K Vushtrri, Kosovë**


Kopje: Menaxheri i Kontratës;

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;

Drejtorisë së Prokurimit;

Drejtorit të Njësies Kërkuese

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Numri i prokurimit: VU644-25-8081-2-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-25-058-221 Titulli: Larja e veturave

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin ,0%;8%;apo18%.
Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH.
Çmimi duhet të shkruhet me dy decimale pas presjes dhjetore, në të kundërtën nuk do të merret për bazë numri i tret pasë presjes

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Pastrimi - larja e jashtme dhe e brendshme	Copë	2600.00	5.08	18.00	6.00	13,220.34	2,379.66	15,600.00
2	Larja Speciale e automjeteve duke e përfshirë karrikat, tepihat, motorin, instrumentablën, taparicat, gepekun.	Copë	80.00	21.19	18.00	25.00	1,694.92	305.08	2,000.00
3	Larja e motorit	Cope	50.00	4.24	18.00	5.00	211.86	38.14	250.00
TOTALI PËRGJITHSHËM:							15,127.12	2,722.88	17,850.00

Numri i prokurimit: VU644-25-8081-2-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-25-058-221 Titulli: Larja e veturave

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	TILI CLEANING SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	BAHTIR MEHMETI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	25.09.2025
VULA:	

AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRRIË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 644-25-8081-2-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Tili Cleaning SH.P.K., Rr.Enver Zymberi, 42000, Vushtrri, Kosovë

E-mail: tili.cleaning@gmail.com

Personi kontaktues: Bahtir Mehmeti

Telefoni: 049 170 204

Faxi:

Numri fiskal: 812021476

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):